

Sanxhaku i Dukagjinit dhe dy regjistrimet e viteve 1571 dhe 1591

Lezha, Debri, Spasi, Puka, Iballa, Fanti i Madh dhe i Vogël, Mirdita, Zadrime dhe Rragami

Ermal Nurja

Sanxhaku i Dukagjinit ishte një ndër sanxhaqet që formonin vilajetin e Rumelisë gjatë periudhës së sundimit klasik osman. Rumelija ishte një nga dy nënndarjet e mëdha administrative të Perandorisë Osmane, që bashkë me Vilajetin e Anadollit lindën dhe u zhdukën së bashku me Perandorinë (në periudha të caktuara të historisë osmane ka pasur edhe nëndarje të tjera të mëdha siç qe ajo e Hixhazit dhe e Afrikës Veriore që qenë më jetëshkurtra).

Në lidhje me themelimin e sanxhakut të Dukagjinit janë përcaktuar nga historianët dhe studiuesit data të ndryshme, në varësi të dokumentacioneve historike që ata kanë pasur në dispozicion. Gjithashtu nuk mund të anashkalohet mundësia që sanxhaku të ketë ekzistuar në periudha të ndryshme, mes të cilave edhe nëse *de jure* ka ekzistuar, *de facto* pushteti osman nuk ka ekzistuar.

Duke pasur parasysh këtë fakt mund të themi se data e dokumentuar e themelimit të parë të Sanxhakut të Dukagjinit është viti 1436.¹ Kjo datë e dokumentuar na lejon të krijojmë hipotezën se Sanxhaku i Dukagjinit së bashku me pjesën tjetër të Sanxhakut Arvanid duhet të jetë krijuar gjatë sundimit të sulltan Mehmetit I, pas viteve 1415. Me shumë gjasa treva e Dukagjinit, më saktë një pjesë e saj u përfshi në mosbindjen e përgjithshme që filloi me kryengritjen e Skënderbeut pas vitit 1444. Mjafton të kujtojmë se regjistruesit e regjistrit të Sanxhakut të Dukagjinit kishin të Spasit, Pukës dhe Iballës i kanë regjistruar edhe me emrat Pulti i Lekës, ndërsa në një rast e kanë regjistruar në formën Pulti i Lekë Zaharisë. Situata duhet të

1 Osmanlı Arşiv Belgelerinde Arnavutluk / Shqipëria në dokumentet arkivale otomane, Botim i Arkivit Osman, İstanbul 2008, fq. 270.

ketë vazhduar e tillë deri në vitin 1468, kur pas fushatës osmane të drejtuar nga Mehmeti II u krye edhe regjistrimi i trevave që kishin marrë pjesë në kryengritjen e Skënderbeut dhe u ndërtua kalaja e Elbasanit.²

Sanxhaku i Dukagjinit dokumentohet për herë të dytë në regjistrin e taksës së xhizjes së Rumelisë në vitin 1491, ndonëse kadiu i Dukagjinit njoftonte se nuk ishte e lehtë për t'ua grumbulluar mbledhja e xhizjes në këtë sanxhak.

Në lidhje me regjistrimin e detajuar të sanxhakut të Dukagjinit deri më sot janë konstatuar vetëm dy regjistra të llojit tahir.

Regjistri i parë gjendet në Arkivin Osman të Stambollit, në fondin e Regjistrave Tahir, me numër 499. Regjistri mban datën 1571 (978 Hixhri).

Regjistri i dytë deri në vitin 2018 gjendej në qytetin e Ankarasë, në Arkivin e Tapive që varet nga Ministria e Punëve Publike. Prej vitit 2018 fondi i regjistrave me vlerë historike u transferua në Arkivin Osman të Stambollit. Ai mban indikacionin arkivor, TKG M, No. 62 dhe ka datën 1591 (evail xhymadelevel 999 H).

Sanxhaku i Dukagjinit formohej nga kazatë e Debrit, Spasit, Pukës, Iballës, Fandi i Madh, Fandi i Vogël, Mirdita, Rudina, Domoshtica, Pashtrik, Luma, Gora, Opoja, Dibra, Zadrime dhe Rragami.

Në këtë artikull do të trajtohen vetëm një pjesë e kazave, ndërsa në numrin e ardhshëm të revistës *Albanon* do të trajtohen kazatë e tjera.

Kazatë Grbavçe, Zhupa, Malonshik, Ploshevica, Cetina, Rjeka, Cernica, Grblan i Sipërm dhe Grblan i Poshtëm që janë regjistruar në regjistrin e vitit 1571 të sanxhakut të Dukagjinit, megjithëse nuk bënë pjesë në këtë sanxhak dhe sot gjenden brenda kufijve të Republikës së Malit të Zi, nuk do të trajtohen as në këtë artikull, as në artikullin pasardhës.

Në dallim nga kazatë e tjera të sanxhakut të Dukagjinit, që do të trajtohen në numrin e ardhshëm të revistës *Albanon*, procesi i islamizimit ende është i ngadaltë edhe në fundin e shekullit të XVI. Myslimanët janë regjistruar në formë vatrash, beqarë dhe të sapomartuar (benak). Tërheq vëmendjen fakti që në disa raste, vatrast myslimane të regjistruara në vitin 1571 nuk shfaqen në vitin 1591. Gjatë kësaj periudhe familjet në fjalë duhet të kenë emigruar në fshatra ose qytete të tjera. Rastet e islamizimeve të regjistruara gjenden në tabelën e mëposhtme:

2 Regjistri osman gjendet në arkivin osman nën referencën arkivore BOA, MAD.d, No. 805. Pjesa për Shqipërinë është përkthyer në shqip dhe gjendet në botimin Selami Pulaha, Lufta shqiptaro-turke në shekullin e XV: Burime osmane, Tiranë 1968, f. 326-374.

1571	Timarliu	Kazaja	Fshati	Myslimanë					
				1571			1591		
				Vatrat	Beqarë	Sapomartuar	Vatrat	Beqarë	Sapomartuar
Sulltani	Sulltani		Lezha (qytet)	2	0	0	6	0	0
Sanxhakbej	Sanxhakbej	Debri dhe Gjadra	Shqsta	0	0	0	2	0	0
ibid	ibid	ibid	Gurbardhi	0	0	0	1	0	0
Sanxhakbej	Sylejman	ibid	Gjonale	0	0	0	1		
Muharrem Abdullah	Muharrem Abdullah	ibid	Raboshta	0	0	0	5	1	0
ibid	ibid	ibid	Nabza	1	0	0	0	0	0
ibid	ibid	ibid	Mabza	2	0	0	0	0	0
Sulltan	Sulltan	Spas	Mamis	0	0	0	4	0	0
ibid	ibid	ibid	Kolshi	1	0	0	1	1	0
Sanxhakbej	ibid	ibid	Spasi	0	0	0	4	0	0
ibid	ibid	ibid	Stënlli	2	0	0	4	0	1
ibid	Ahmed Mehmed	ibid	ishtanja	1	0	0	3	0	0
ibid	Sanxhakbej	ibid	Kruamadh	0	0	0	7	0	1
ibid	Sanxhakbej	ibid	Kllogjin	2	0	0	2	0	1
ibid	Ahmet Mehmet zaim	ibid	Shen Merija	4	0	0	5	0	0
ibid	Sanxhakbej	ibid	Mogula	1	0	0	1	0	0
ibid	ibid	ibid	Shparret	1	0	0	3	0	0

1571	Timariu	Kazaja	Fshati	Myslimanë					
				1571			1591		
				Vatrat	Beqarë	Sapomartuar	Vatrat	Beqarë	Sapomartuar
ibid	Ahmet Mehmet zaim	ibid	Peta	0	0	0	1	0	0
ibid	Sanxhakbej	ibid	Olomisht	9	0	0	4	1	3
ibid	ibid	ibid	Suroj	3	0	0	2	1	1
ibid	Sylejman	ibid	Arren	1	0	0	1	0	0
Sanxhakbej	Sanxhakbej	Puka	Dosh	1	0	0	1	0	0
ibid	ibid		Qereti sipërm	3	0	0	3	0	0
ibid	ibid		Qereti poshtëm	2	0	0	0	0	0
ibid	ibid		Manja	0	0	0	1	0	1
ibid	ibid		Shenkoll	0	0	0	2	0	0
ibid	ibid		Shen Pal	0	0	0	1	0	0
ibid	ibid		Ras	0	0	0	2	0	0
ibid	Hasan		Bilishta	0	0	0	0	0	2
X	Ushtarët e kalasë së Dukagjimit	Fandi i madh	Lagja Mashta e fshatit Rihna	1	0	0	0	0	0
Prona private e Mustafa pashës	Prona private e Mustafa pashës	Rragam	Lesna	0	0	0	4	0	0
Totali				37	0	0	71	4	10

1. Qyteti i Lezhës

Qyteti i Lezhës me kalanë e saj ishte qendra administrative e Sanxhakut të Dukagjinit. Ishulli i Lezhës është regjistruar në statusin truallishtë (mezra) që punohet nga banorët e qytetit të Lezhës. Taksat e tregut të Lezhës, doganës së Lezhës, kriprores së Lezhës, kapitenarisë (kapudan) së Lezhës, nxjerrjes së katranit, kriprores së Lezhës, martesave dhe akteve penale që kryheshin në qytetin e Lezhës ishin të ardhura që shkonin për llogari të Sulltanit, i cili i administronte me rrugë sipërmarrjeje (mukata). Popullsia e regjistruar si në vitin 1571 ashtu edhe në vitin 1591 formohet vetëm nga vatrat. Nuk ka beqarë, të veja dhe bashkina. Të ardhurat nga taksat e qytetit në vitin 1571 janë 7436 akçe, ndërsa në vitin 1591 janë 8436 akçe. Të ardhurat nga taksat e *mukatave* në vitin 1571 janë 579'832 akçe, ndërsa në vitin 1591 janë 579'832 akçe.³

2. Kazaja e Debrit dhe Gjadrit⁴

Timarliu		Fshati	Vatra		Beqar		Të ardhura	
1571	1591		1571	1591	1571	1591	1571	1591
Sanxhakbeu	Sanxhakbeu	Mngusha	22	78	1	2	1045	1000
İbid	İbid	Korthpula	20	30	0	4	871	1871
İbid	İbid	Kaçinar	9	9	0	0	400	400
İbid	İbid	Shperdhet	13	12	0	0	564	546
İbid	İbid	Gjanis	18	25	2	2	833	1000
İbid	İbid	Kalur	18	11	2	2	978	1500
İbid	İbid	Shqsta	8	19	0	2	443	1000
İbid	İbid	Marshiq	5	21	0	3	251	1000
İbid	İbid	Petrabard (Gurbardhi)	18	13	3	2	1029	500
İbid	İbid	Kashnjet	7	30	1	4	437	1000
İbid	İbid	Rans	3	50	0	0	172	1500
İbid	Süleyman	Gjonale	14	6	0	2	764	750
İbid	Sanxhakbej	Mirqueshta	7	8	0	0	450	450
İbid	İbid	Shkeza	13	18	0	2	620	800
İbid	İbid	Barçor	12	28	0	7	598	1400
İbid	İbid	Shtupanz	6	8	0	0	310	1000
İbid	İbid	Moriqan truallisht					163	163
İbid	İbid	Taksa e kullotës					X	2000
İbid	İbid	Mosol mezra					170	170
İbid	İbid	Taksa e rendit e Debrit dhe Gjadrit					5000	2000
İbid	İbid	Taksa e rendit e Zadrimës					4000	8000

3 BOA, TT, D. 499, s. 18-20; TKGM, D. 62, vr. 5r-6r,

4 BOA, TT, D. 499, s. 16-33; TKGM, D. 62, vr. 6r-12r.

Timarliu		Fshati	Vatra		Beqar		Të ardhura	
1571	1591		1571	1591	1571	1591	1571	1591
Muharrem Abdullah	Muharrem Abdullah	Skanda	41	57	29	7	4600	4600
İbid	İbid	Balgush	24	28	15	4	2500	2500
İbid	İbid	Raboshta	76	18	0	6	X ⁵	3400
İbid	İbid	Nabza	5	14	0	3	330	330
İbid	İbid	Mabza	4	20	0	3	340	340
İbid	İbid	Vran	7	16	0	2	358	358
İbid	İbid	Vela	7	20	0	6	372	372
Spahinjtë e Dukagjinit ⁶	X ⁷	Merqinja	128	X	30	X	X ⁸	X
Total			485	539	83	63	27'598	39'950

3. Kazaja e Spasit⁹

Timarliu		Fshati	Vatra		Beqar		Bashtina		Të ardhura	
1571	1591		1571	1591	1571	1591	1571	1591	1571	1591
Sulltani	Sulltani	Mamis	26	45	2	7	1	0	3000	3000
İbid	İbid	Kolshi	27	38	4	4	1	1	2000	2000
Sanxhakbe	Sanxhakbe	Spas	10	15	0	0	0	0	466	1500
İbid	İbid	Shënlli	21	10	3	2	3	6	1029	1000
İbid	Ahmed Mehmed	Shtupanja	15	18	0	5	2	2	768	800
İbid	Sanxhakbe	Kruamadh	11	11	0	1	0	0	595	1500
İbid	Sanxhakbe	Klllogjin	7	7	0	0	1 ¹⁰	1 ¹¹	436	1600
İbid	Ahmet Mehmet zaim	Kalimariş	21	23	0	5	0	0	973	1000
İbid	İbid	Shen Merija	11	15	1	2	1	1	709	1000
İbid	Sanxhakbe	Shen Kroq	12	19	0	2	2	2	670	950
İbid	İbid	Mogula	16	22	0	3	0	0	761	1050
İbid	İbid	Kolomri	9	12	0	1	0	0	475	700
İbid	İbid	Sakat	12	11	0	1	0	0	782	950
İbid	İbid	Darda	10	10	0	0	0	0	495	800
İbid	İbid	Shparret	14	15	3	3	1	1	1003	1000
İbid	Ahmet Mehmet zaim	Peta	15	24	4	2	0	1	1200	1200

5 Regjistruesi e ka lënë bosh

6 Më përpara ka qenë pjesë e sanxhakut të Ohrit më pas u kalua nën varësinë e sanxhakut të Dukagjinit.

7 E regjistruar nga regjistruesi i sanxhakut të Ohrit.

8 Regjistruesi e ka lënë bosh.

9 BOA, TT, D. 499, s. 37-48; TKGM, D. 62, vr. 13v-18v.

10 Bashtina e Kishës së Shën Marisë

11 Bashtina e Kishës së Shën Marisë

Timarliu		Fshati	Vatra		Beqar		Bashtina		Të ardhura	
1571	1591		1571	1591	1571	1591	1571	1591	1571	1591
İbid	Sanxhakbe	Barniç	12	13	3	2	0	1	818	1250
İbid	İbid	Olomisht	12	22	4	5	0	0	1500	2500
İbid	İbid	Suroj	21	20	2	2	1	1	2000	6000
İbid	Sylejman dhe tjerë	Arren	14	37	3	7	0	0	1200	4000
		Taksa e skelës së Spasit që gjendet në fshatin Sakat.							8000	8000
		Taksa e rendit Spas dhe Puka							3000	4000
		Klomodiz nuk iu gjet as nami as nishani								
Total			296	387	29	54	13	13	31880	45800

Në mesin e kazasë së Spasit në fshatin Sakat kemi dy bazdar (kujdestar fajkonjsh), 1 qefali në fshatin Barniç dhe myselim (të përjashtuar nga taksat) 4 në Barniç, 1 në Kllogjin dhe 2 në Kolshi, që mirëmbajnë urën mbi lumin Leshtenja, si dhe 1 në Shtanja.

Në Olomisht në vitin 1591 kemi dy vatra të ardhura nga fshati Skura.

4. Kazaja e Pukës, ndryshe quhet edhe Mali Zi¹²

Në vitin 1591 në fshatin Bardhed kemi tri vatra të ardhura nga fshati Çagn, në fshatin Ripa kemi një beqar të ardhur nga fshati Dobrishta, në fshatin Dosh kemi një vatër të ardhur nga fshati Kanoz, në fshatin Bilishta/ Belishja kemi 1 vatër të ardhur nga fshati Brataniça.

Kemi 1 qefali në fshatin Ripa, 1 myselim nga fshati Qereti Sipërm, 1 qefali në fshatin Bogdan-Buzan,

Në fshatin Arsti është regjistruar 1 bashtinë, ndërsa në fshatin Qeret i Sipërm është regjistruar 1 çiflig.

Timarliu		Fshati	Vatra		Beqar		Të ardhura	
1571	1591		1571	1591	1571	1591	1571	1591
Sanxhakbej	Sanxhakbej	Bardhed	25	26	0	2	1059	1500
İbid	İbid	Vila	12	36	0	2	505	1500
İbid	İbid	Arsti	13	15	0	2	655	1000
İbid	İbid	Ripa	21	22	0	3	846	1150
İbid	İbid	Kçira	8	5	0	0	354	1000

12 BOA, TT, D. 499, s. 53-62, TKGM, D. 62, vr. 19v-24v.

Timarliu		Fshati	Vatra		Beqar		Të ardhura	
1571	1591		1571	1591	1571	1591	1571	1591
İbid	İbid	Dosh	13	33	0	7	552	2500
İbid	İbid	Shkoza	10	5	0	0	521	521
İbid	İbid	Qereti sipërm	12	13	0	0	492	1500
İbid	İbid	Qereti poshtëm	11	51	0	15	393	2000
İbid	İbid	Zenat	6	20	0	5	293	500
İbid	İbid	Manja	15	16	5	4	987	978
İbid	İbid	Shenkoll	10	9	2	2	575	575
İbid	İbid	Dushnjeza	17	11	2	2	815	815
İbid	İbid	Lepurushk	8	2	3	0	794	274
İbid	İbid	Bogdan-Buzan	7	11	2	2	483	484
İbid	İbid	Mirat	4	17	0	0	186	1000
İbid	İbid	Shen Pal	12	10	4	4	1134	1134
İbid	İbid	Ras	6	28	0	5	210	500
İbid	Hasan	Bilishta	18	24	2	2	886	1000
İbid	Sanxhakbej	Karma mezra					200	200
Sylejman Ishak ushtari kalasë Dukagjinit	Sylejman Ishak ushtari kalasë Dukagjinit	Koman mezra					600	700
İbid	İbid	Dubrova					800	800
X	Sanxhakbej	Taksa e rendit e Pukës					X	6000
Total			228	354	20	57	13'340	27'631

5. Kazaja e Iballës¹³

Në vitin 1591 të ardhurat e kazasë së Iballës shkonin të gjitha për ushtarët e kalasë së Dukagjinit.

Në kazanë e Iballës është regjistruar vetëm 1 bashtinë në fshatin Ilishqa.

Timarliu	Fshati	Vatra		Beqar		Të ardhura	
		1571	1591	1571	1591	1571	1591
	Iballa	61	82	18	20	7500	9000
	Ashta	19	36	1	6	1900	3400
	Gralisht	19	24	2	3	1995	3495
	Fierza	9	12	4	2	1235	1435
	Porava	7	7	3	3	950	950
	Ripa e Sipërme	5	6	1	1	570	570

13 BOA, TT, D. 499, s. 67-76, TKGM, D. 62, vr. 25v-29r.

Timarliu	Fshati	Vatra		Beqar		Të ardhura	
		1571	1591	1571	1591	1571	1591
	Arsta	8	8	1	2	855	855
	Miraskela	11	12	4	3	1425	1425
	Frashni	6	10	4	3	950	955
	Ripa e poshtme	12	16	3	3	1425	1425
	İlishqa	8	16	1	3	950	1950
	Dobruna	12	16	4	4	1520	1520
	Sopan	18	30	6	6	2280	3380
	Blçna	19	28	8	4	2565	2565
	Shupan	24	23	5	4	2755	2755
	Mërtur	19	16	8	3	2065	2565
	Bab, bosh	0	0	0		355	355
Total		257	342	73	70	31'295	38'600

6. Kazaja e Fandit të Madh¹⁴

Në vitin 1591 të ardhurat e kazasë së Fandit të Madh shkonin të gjitha për ushtarët e kalasë së Dukagjinit.

Në vitin 1591 në fshatin Rihna ishte vendosur 1 vatër nga fshati Shakoll dhe 1 nga lagja Mashta e fshatit Rihna. Po ashtu në fshatin Tirdhot është vendosur 1 vatër nga fshati Shakoll.

Timarliu		Fshati	Vatra		Beqar		Të ardhura	
1571	1591		1571	1591	1571	1591	1571	1591
		Rihna	18	18	0	3	X	X
		Mashta lagje	13	8	0	5	2208	2208
		Todhri	24	25	3	3	1863	2863
		Lukani	11	5	1	0	828	828
		Munella	16	14	0	0	X	X
		Kimza mah	14	9	1	1	2139	2139
		Tirdhot	16	12	0	0	1100	1100
		Shkoza	17	11	2	2	1310	1300
		Ishmak	8	6	0	0	552	525
		Qarr mezra, bosh						
Total			137	108	7	14	10'000	10'963

14 BOA, TT, D. 499, s. 77-82; TKGM, D. 62, vr. 30v-31r

7. Kazaja e Fandit të Vogël¹⁵

Në vitin 1571 fshatrat e kazasë së Fandit të Vogël nuk janë regjistruar, veprim që në administratën osmane konsiderohej si formë mosbindjeje. Megjithatë të ardhurat e mundshme që mund të mblidheshin nga ato fshatra janë përcaktuar nga njohës të mirë të kazasë, popullsisë dhe produkteve që mund të mblidhen prej tyre. Kjo gjendje ka ndryshuar në vitin 1591, kur janë regjistruar me emra banorët e atyre fshatrave dhe taksat që ata duhen të pagonin.

Timarliu		Fshati	Vatra	Të ardhura	
1571	1591		1591	1571	1591
Mustafa	Korkud sanxhakbej i Dukagjinit	Pine	44	2879	6000
İbid	İbid	Bera	11	2228	1228
İbid	İbid	Katra	38	1845	1845
İbid	İbid	Gjonm	48	2390	1390
İbid	İbid	Grasht	43	656	656
Hasan dhe Mustafa	İbid	Shën Gjergj	6	1500	1500
İskender Hysen	İbid	Shen Mark	18	500	500
Mustafa İljaz	İbid	Kuqin	4	1400	1400
Mustafa	İbid	Mirgjesht, hali		X	500
Mustafa	İbid	Ostrojka		X	500
Taksa e rendit Fanta				0	2000
Taksa e bagëtive e kazave të Debrit, Mirditës, Pukës, Spasit, Fandit të Madh dhe të Vogël ve İbalës				0	13500
Total			212	13'398	31'019

8. Kazaja e Mirditës¹⁶

Sipas një anëshkrimi që gjendet në regjistrin e vitit 1571 shkruhet se kazaja në fjalë në një regjistër të mëparshëm (defter-i atik), data e të cilit nuk shkruhet, ka qenë e regjistruar nën varësinë administrative të Fandit të Vogël, ndërsa në këtë kohë është krijuar kazaja e Mirditës. Në vitin 1571, me përjashtim të fshatit Blakza e Sipërme dhe e Poshtme, banorët e të cilëve janë regjistruar, 9 fshatrat e tjera që formonin kazanë e Mirditës nuk ishin paraqitur që të regjistroheshin. Vlera e taksës së fshatrave në fjalë në këtë vit është caktuar nga njohësit e zonës (ehl-i vukuf). Në vitin 1591 situata ndryshon. Në këtë vit janë regjistruar me emra edhe banorët e fshatrave të tjera të kazasë së

15 BOA, TT, D. 499, s. 85-86; TKGM, D. 62, vr. 32v-34v.

16 BOA, TT, D. 499, s. 87-89; ; TKGM, D. 62, vr. 35v-

Mirditës. Beqarë janë regjistruar vetëm në vitin 1571, në total 3 në fshatin Blakza e poshtme, të cilët nuk figurojnë në vitin 1591.

Timarliu		Fshati	Vatra		Të ardhurat	
1571	1591		1571	1591		
Hysen Iskender	Sanxhakbej	Blakza e poshtme	14	11	1200	1000
Ushtarët e kalasë së Lezhës	Ushtarët e kalasë së Lezhës	Blakza e sipërme	11	8	1800	1800
	İbid	Mirdid	X	46	3500	3500
	İbid	Aramirza	X	20	3000	3000
	İbid	Gorshet	X	11	1500	1500
	İbid	Villa	X	26	3000	3000
	İbid	Belesh	X	12	2000	2000
	İbid	Shen Kostandin	X	11	2200	2200
Ymer Iljasi, ushtari i kalasë së Dukagjinit	İbid	Tagmesh	X	23	1400	1400
Total			25	168	19'600	19'400

9. Zadrime (166-172/417-428)

Sipas anëshkrimit në regjistrin e vitit 1571 kazatë e Zadrimes dhe të Rragamit në një regjistër të mëparshëm figuronin me të ardhura 11'766 akçe, ndërsa më pas i qenë caktuar si pronë private (mylk) në muajin shtator të vitit 1524 (Zilkade 930) Mustafa pashës. Akti i dhënies në pronësi (mylkname) të këtyre dy kazave që depozituar në regjistrin perandorak nga Ibrahim pasha dhe Ajas pasha.¹⁷

Në një anëshkrim tjetër në regjistrin e vitit 1591 shkruhet se, popullsia e Zadrimes dhe e Rragamit, që nga koha që kalaja e Shkodrës u mor nga sulltan Mehmeti II, qenë përjashtuar nga pagimi i taksave, pasi kryenin shërbime logjistike për kalanë e Shkodrës, më konkretisht ata merreshin me mirëmbajtjen e puseve të kalasë, transportin e drithrave për hambarët e kalasë, mirëmbajtjen e rrugëve dhe urave që shkonin deri në skelën e Lezhës, prerjen e lëndës drusore dhe transportin e saj deri në kalanë e Lezhës, mirëmbajtjen e urës së Gostiqes, punë që kapte vlerën 15'000 akça, kontrollin e dervenit të Skanjës dhe 32 urave në total. Akti i fundit i lëshuar nga financa perandorake që rikonfirmonte përjashtimin e tyre nga taksat kundrejt këtyre shërbimeve mban datën 983 H.¹⁸

17 BOA, TT, D. 499, s. 417; TKGM, D. 62, vr. 113v.

18 TKGM, D. 62, vr. 113r;

Zadrimea në vitin 1571 kishte nën varësinë e saj 23 fshatra dhe 3 truallishte (mezra): Shelqeti, Midh dhe Baba.¹⁹

	Fshati	Vatra		Beqar		Bashtina		Të ardhura	
		1571	1591	1571	1591	1571	1591	1571	1591
1.	Ranza	12	24	0	0	1	1	500	770
2.	Pistull	9	9	0	0	0	0	350	388
3.	Paçram	7	9	0	0	0	0	255	350
4.	Çeravina	24	28	6	4	2	2+1çiftlik	1030	1093
5.	Shkjeza	16	21	2	2	0	0	700	800
6.	Dragush	15	18	0	0	2	2	560	630
7.	Gjadri	22	31	3	2	1	1	740	1000
8.	Gramshe	14	15	3	2	0	0	555	565
9.	Qerose	22	31	0	2	0	0	720	1020
10.	Dajç	15	25	0	0	2	0	625	770
11.	Baba	21	27	4	2	3	1	850	936
12.	Hajmel	25	35	1	2	4	0	950	1070
13.	Zojsi	11	14	0	0	0	0	390	473
14.	Nikli	13	21	0	0	1	1	435	749
15.	Kashnjeta	10	14	0	0	1	0	350	483
16.	Nenshat	33	44	6	5	2	0	1240	1433
17.	Kallmet	11	28	5	2	1	0	515	870
18.	Troshan	19	24	0	2	1	0	588	793
19.	Laç	18	24	5	3	0	0	730	858
20.	Midh	33	40	2	4	0	0	1062	1275
21.	Blinisht	38	60	4	4	0	0	1300	1263
22.	Butaç	14	8	4	1	0	0	611	606
23.	Pema	12	12	1	3	0	0	325	504
Total		421	562	46	40	20	8+1çiftlik	15'286	18'699

10. Rragami (173-174 / 430-433)

Kazaja e Rragamit përbëhej nga 10 fshatra në vitin 1571, ndërsa në vitin 1591 janë regjistruar 9 fshatra. Fshati Skanda nuk figuron në vitin 1591, ndërsa në vitin 1571 regjistruesi shkruan se nuk iu gjet nami as nishani gjatë regjistrimit.²⁰ Përsa i takon bashtinave ato gjenden në fshatin Kotrr, vetëm 1 në vitin 1571, që nuk figuron më në vitin 1591 dhe në fshatin Radina/Zadina, 2 bashtina që figurojnë në të dy vitet e regjistrimeve.

19 BOA, TT, D. 499, s. 418-429; TKGM, D. 62, vr. 113r-119r.

20 BOA, TT, D. 499, s. 430-433; TKGM, D. 62, vr. 119r-121r.

	Fshati	Vatra		Beqar		Të ardhura	
		1571	1591	1571	1591	1571	1591
1.	Vidin	7	5	2	0	690	275
2.	Vjerdha	11	12	1	2	390	459
3.	Busa Shakoll	7	5	0	0	255	265
4.	Lesna	10	9	0	0	320	400
5.	Qyrsak	3	7	0	0	107	219
6.	Mirdija	8	6	1	1	260	260
7.	Mirleshta	7	7	0	0	250	250
8.	Kotri	28	32	3	7	905	1192
9.	Radina	7	7	0	0	285	358
10.	Skanda	0	X	0	0	0	0
Total		91	90	7	10	3462	3705